



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË
DEGA VENDORE DURRËS

NOTER INES V. ALEKSI
ADRESA NR.11, ALEKSANDER
GOGA
TEL: 692061695

KONTRATË DHURIMI PASURI E LUAJTSHME (KUOTA KAPITALI)

Nr. repertori: 956

Nr. koleksioni: 497

Durres më 16/03/2022



Ligjet referuese:

- 1.Ligji nr. 7850, datë 29/07/1994 "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar
- 2.Ligji nr. 9887, date 10/03/2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar
- 3.Ligji nr. 110, datë 20/12/2018 "Për Noterinë"



A2022011920016890411



A2022011920016890411

KONTRATË DHURIMI KUOTASH KAPITALI

(Bazuar ne nenin 705 e vijim te Kodit Civil, Ligji 9901 date 14.04.2008 "Per tretaret dhe shoqerite tregtare", Ligji 9723 date 03.05.2007 "Per qendren e regjistrimit" si dhe Statuti i Shoqerise "JEDAS" shpk)

Sot, më datë 16.02.2022, para meje Notere INES V. ALEKSI, anëtare në Dhomën Kombëtare të Noterisë, Dega Vendore DURRËS, me zyrë në adresën Durres, NR.11, ALEKSANDER GOGA, u paraqit personalisht:

DHURUES:

Selim Doma, atësia Bajram, amësia Nazmije, shtetas Shqiptar, lindur në Kuraten, Durrës dhe banues në Durrës, me adresë Durrës, lindur më 18/06/1957, gjendja civile "i martuar", madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Leternjoftim ID nr. 036021931 dhe nr. personal F70618001N, ortak me 50% te kuotave te shoqerise "JEDAS"shpk, shoqeri tregtare me pergjegjesi te kufizuar, eshte e regjistruar si person juridiki prane Zyres se Regjistrimit Tregtar, prane Qendres Tregtare te Regjistrimit (QKR), me date 28.06.2006, Certifikate Regjistrimi (NUIS) K81806505G, me seli ne Durres, Lagjia 17, Rr.Dalip Peza, p.978, sh.1, k.1, nr pasurie 5/322-N, ZK 8513,

DHURUES:

Bujar Doda, atësia Hysen, amësia Sabrije, shtetas Shqiptar, lindur në Draç, Durrës dhe banues në Durrës, me adresë R.1"currila"; Durrës, lindur më 05/09/1957, gjendja civile "i martuar", madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Leternjoftim ID nr. 036451119 dhe nr. personal F70905001D, ortak me 50% te kuotave te shoqerise "JEDAS"shpk, shoqeri tregtare me pergjegjesi te kufizuar, eshte e regjistruar si person juridiki prane Zyres se Regjistrimit Tregtar, prane Qendres Tregtare te Regjistrimit (QKR), me date 28.06.2006, Certifikate Regjistrimi (NUIS) K81806505G, me seli ne Durres, Lagjia 17, Rr.Dalip Peza, p.978, sh.1, k.1, nr pasurie 5/322-N, ZK 8513,

(Këtu e në vijim, për efekt të kësaj kontrate referuar si "Dhuruesi")

PRANUES I DHURIMIT:

Dorian Doma, atësia Selim, amësia Hamide, shtetas Shqiptar, lindur në Manëz, Durrës dhe banues në TIRANË, me adresë Farkë; Selitë; Tiranë, lindur më 17/02/1987, gjendja civile "i martuar", madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Leternjoftim ID nr. 036022496 dhe nr. personal I70217063L, .

(Këtu e në vijim, për efekt të kësaj kontrate referuar si "Përfituesi i dhurimit")

Rrethanat e hartimit të aktit noterial:

Personat e lartpërmendur u paraqitën me vullnetin e tyre të lirë, të plotë e të pavesuar dhe deklaruan se kërkojnë hartimin e kësaj kontrate për dhurimin e kuotave të kapitalit. Unë noteri/ja, pasi verifikova identitetin e tyre dhe dokumentet e paraqitura, hartoj këtë kontratë, në bashkëpunim me palët, duke përcaktuar kushtet e mëposhtme:



A2022011920016890411

Kushtet paraprake

- Shoqëria "JEDAS" shpk, shoqëri tregtare me përgjegjësi të kufizuar, është e regjistruar si person juridik pranë Zyres së Regjistrimit Tregtar, pranë Qendres Tregtare të Regjistrimit (QKR), me datë 06.06.2008, Certifikatë Regjistrimi (NIPT) K81806505G, me seli në Durrës, me kapital të regjistruar **325.000.000 (treqindnjzetepesemilion) leke**, të zotëruara nga Bujar Doda me 50 % të kuotave, nga ortaku Selim Doma me 50 % të kuotave,
- **Bujar Doda**, pala dhuruese në këtë kontratë, është pjesëmarrës me 50 % të kuotave të Shoqërisë "JEDAS" shpk në vlerën totale 162.500.000 leke.
- **Selim Doma**, pala dhuruese në këtë kontratë, është pjesëmarrës me 50 % të kuotave të Shoqërisë "JEDAS" shpk në vlerën totale 162.500.000 leke.
-
- Me vendimin e datës 16 .02.2022 të asamblesë së përgjithshme të ORTAKEVE të Shoqërisë "JEDAS" shpk është vendosur ndër të tjera dhe miratimi për dhurimin e 7.5% të kuotave të kapitalit që ortaku I shoqërisë Bujar Doda dhe 7.5% të kuotave të kapitalit që ortaku I shoqërisë Selim Doma zoteron në shoqëri, në favor të ortakut të ri në shoqëri Dorian Doma, e cila gjithashtu me vendimin e datës 16 .02.2022 të asamblesë së përgjithshme të përberë nga ortakët si më sipër, ka vendosur që kjo kontratë të nënshkruhet nga vetë ortakët dhe të bëhet pranimi i dhurimit nga ortaku i ri Dorian Doma.

I. OBJEKTI

- I.1** Nepermjet kesaj kontrate pala dhuruese Bujar Doda dhe Selim Doma i dhurojne pales pranuese te dhurimit Dorian Doma (njekohesisht edhe I biri I dhuruesit Selim Doma) 7.5% te kuotave qe secili nga dhuruesit zoteron ne kapitalin e regjistruar te shoqerise "JEDAS" shpk dhe qe perbejne ne total 15 % te kapitalit te kesaj shoqerie.

II. CMIMI

- II.1** Palet kane rene dakord qe transferimi I kuotave behet pa asnje shperblim financiar dhe me menenshkrimin e kesaj kontrate asnjera nga palet nuk ka pretendime te tjera lidhur me kete fakt.

III. KALIMI I PRONESISE

- III.1** Pronesia mbi 15 % të kuotave të kapitalit të regjistruar të shoqërisë "JEDAS" shpk do të kalojë nga pala dhuruese Bujar Doda dhe Selim Doma tek pala pranuese e dhurimit Dorian Doma pas depozitimit të kesaj kontrate në Zyren e Regjistrimit Tregtar, pranë Qendres Kombëtare të Regjistrimit.
- III.2** Nga moment I depozitimit të kontratës në Zyren e Regjistrimit Tregtar pala dhuruese Bujar Doda dhe Selim Doma humbet të drejtën e pronësive mbi kuotat e kapitalit të zotëruara në Shoqërinë "JEDAS" shpk dhe keto të drejta fitohen nga pala pranuese e dhurimit Dorian Doma ortaku I ri në masën e 15 % të kuotave të shoqërisë "JEDAS" shpk, I cili bëhet nga ky moment pronar 15 % të kuota të kesaj shoqërie në masën 15% Te kapitalit themeltare.
- III.3** Pas ketij veprimi:
- Vlera e kapitalit është **325.000.000 leke**
 - Numri i kuotave do të jetë 3, nga e cila 1 kuote do të zotërohen nga ortaku i mëparshëm Bujar Doda, një kuota nga ortaku I mëparshëm Selim Doma dhe një kuota nga pranuesi i ri i dhurimit me anë të kesaj kontrate, Dorian Doma.
 - Vlera e kuotes së dhuruar është në masën 15 % të kuotave të shoqërisë.



A2022011920016890411

- Ortaku Bujar Doda zoteron 42.5% te kuotave te pjesemarrjes te perbere nga nje kuota ne vleren 138.125.000 leke, ortaku Selim Doma zoteron 42.5 % te kutave te pjesemarrjes te perbere nga nje kuote ne vleren 138.125.000 leke dhe ortaku I ri Dorian Doma zoteron 15% te kuotave te pjesemarrjes te perbere nga nje kuota ne vleren 48.750.000 leke.

Kjo kontrate hartohet ne 4 (kater) kopje autentike nga te cilat nje qendron ne zyren e noterise, nje kopje duhet te depozitohet ne Zyren e Regjistrimit Tregtar prane Qendres Kombetare te Regjistrimit (QKR), nje kopje duhet te depozitohet te seline e shoqerise dhe nje kopje e marrin palet pjesemarrrese ne kete kontrate.

Baza Ligjore

Neni 761 e vijues të Kodit Civil.

Neni 73, pika 1, gërma "ç" (për kuotat e shoqërive me përgjegjësi të kufizuar ose neni 117, pika 1, gërma "ç" (për aksionet e shoqërive aksionare/anonime) të Ligjit nr. 9901, datë 14.08.2009 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", i ndryshuar.

Neni 62, gërma "ll", neni 63, pika 1, gërma "ç", si dhe nenet 99, 100, 101 e vijues të Ligjit nr. 110/2018, datë 20.12.2018 "Për Noterinë".

Dispozitat Përfundimtare

Kontrata e dhurimit, u lexua nga unë Noterja me zë të lartë dhe në mënyrë të qartë në prani të palëve kontraktuese, të cilët më deklaruan se e kuptuan përmbajtjen e saj dhe meqenëse ajo shpreh vullnetin e tyre të lirë e të plotë, u njohën dhe i kuptuan efektet e saj juridike, e nënshkruajnë atë rregullisht përpara meje Noteres.

Unë Noterja, verifikova identitetin e palëve kontraktuese nëpërmjet dokumenteve të identitetit dhe pasi e gjeta përmbajtjen e aktit noterial të mësipërm, në përputhje të plotë me nenin 62, 63 të ligjit nr. 110/2018 "Për Noterinë", vërtetoj nënshkrimin e tyre.

Në zbatim të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave Personale", unë Noterja deklaroj se do të ruaj dhe përpunoj të dhënat personale të subjekteve të kësaj Kontrate, në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme.

DHURUESI

Bujar Doda
Selim Doma

PRANUESI DHURIMIT

Dorian Doma

NOTERE

INES V. ALEKSI